REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT

PËR

4 MUJORIN E DYTË TË VITIT 2026

PËRMBAJTJA

1- HYRJE

1.1 Misioni i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

1.2 Fushat e Përgjegjësisë Shtetërore

1.3 Programet Buxhetore

2- INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

3- PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

4- PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 Performanca Financiare e Programit Buxhetor

4.2 Performanca Jo Financiare e Programit Buxhetor

4.3 Veprimet vijuese në Nivelin e Programit Buxhetor

5- PROJEKTET KAPITALE

6- NDRYSHIMET NË BUXHET

7- PËRFUNDIME

1. HYRJE

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 është hartuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar; Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; Udhëzimit standard nr. 14, datë 30.05.2023, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"; Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026".

1.1 MISIONI

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, ujësjellës-kanalizimeve, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve natyrore, si dhe në sektorin e industrisë minerare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

1.2 FUSHAT E PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të VKM-së nr.508, datë 25.09.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".

1.3 PROGRAMET BUXHETORE

Në zbatim të ligjit 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026" (të ndryshuar), MIE menaxhon 11 programe buxhetore si vijon:

1. Transporti Rrugor
2. Transporti Detar
3. Transporti Hekurudhor
4. Transporti Ajror
5. Furnizim me Ujë dhe Kanalizime
6. Mbështetje për Energjinë
7. Mbështetje për Burimet Natyrore
8. Mbështetje për Industrinë
9. Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit
10. Planifikim Urban
11. Planifikim Menaxhim Administrim

Në zbatim të ligjit 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", buxheti 2026 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është në vlerën 77,255,378,000 lekë, i detajuar sipas shpenzimeve:

- Shpenzime korrente 6,975,807,000 lekë
- Shpenzime kapitale 70,279,571,000 lekë

nga të cilat:

- *shpenzime kapitale me financim të brendshëm 56,208,547,000 lekë*
- *shpenzime kapitale me financim të huaj 14,071,024,000 lekë*

Plani i rishikuar i buxhetit, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë arriti në vlerën 61,488,203,000 lekë për 4- mujorin e II të vitit 2026 sipas shpenzimeve:

- Shpenzime korrente 6,980,917,000 lekë
- Shpenzime kapitale 54,507,286,000 lekë

  nga të cilat:

  - *shpenzime kapitale me financim të brendshëm 41,386,262,000 lekë*
  - *shpenzime kapitale me financim të huaj 13,121,024,000 lekë*

Plani fillestar për shpenzimet korrente pësoi ndryshime shtesë në nivel klasifikimi buxhetor në kuadër të miratimit nga Ministria e Financave të:

- ✓ Akordimit të fondit të veçantë në vlerën 5,000,000 lekë;
- ✓ Akordimit shtesë të fondit të veçantë në vlerën 110,000 lekë;

Plani i rishikuar i shpenzimeve kapitale për MIE, pësoi ndryshime buxhetore në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"", në vlerën totale 15,772,285,000 lekë, si vijon:

Plani i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, pësoi ndryshime buxhetore në programet buxhetore si vijon :

- *Programi buxhetor "Transporti Detar" u pakësua në vlerën 14,745,000,000 lekë;*
- *Programi buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", u pakësua në vlerën 45,000,000 lekë;*
- *Program buxhetor "Planifikimi Urban", u pakësua në vlerën 32,285,000 lekë;*

Plani i rishikuar i shpenzimeve kapitale me financim të huaj, pësoi ndryshime buxhetore në programet buxhetore si vijon :

- *Programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", u pakësua në vlerën 1,000,000,000 lekë;*
- *Program buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime", u shtua në vlerën 50,000,000 lekë;*

2. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për periudhën e 4 Mujorit të II për vitin 2026, në nivel programi buxhetor, paraqitet si në tabelën më poshtë:

Emri i Grupit	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	Kodi i grupit			
EMËRTIME		Plani Fillestar Vjetor Viti 2026	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	% e realizimit
Shpenzimet sipas programeve buxhetore					
Kodi i Programit	Emërtimi				
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	768,544,000	769,054,367	389,247,117	51%
04320	Mbështetje per Energjinë	3,585,638,000	2,585,875,200	774,915,196	30%
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	492,590,000	493,460,000	263,383,654	53%
04440	Mbështetje për Industrinë	452,183,000	452,904,200	266,722,911	59%
04520	Transporti Rrugor	35,387,011,000	35,389,003,033	19,137,486,425	54%
04540	Transporti Detar	14,992,130,000	247,500,000	106,153,589	43%
04550	Transporti Hekurudhor	6,437,802,000	6,437,802,000	962,149,832	15%
04560	Transporti Ajror	28,650,000	28,795,000	19,036,666	66%
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	70,000,000	25,000,000	0	0%
06180	Planifikimi Urban	206,333,000	174,168,000	69,194,560	40%
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	14,834,497,000	14,884,641,200	5,232,732,593	35%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise	**77,255,378,000**	**61,488,203,000**	**27,221,022,544**	**44%**
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0	**0**	**123,181,798**	
	Totali Shpenzimeve te Ministrisë	**77,255,378,000**	**61,488,203,000**	**27,344,204,342**	**44%**

Shtojmë në vëmendjen tuaj se :

Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qëndrore", rezultoi se gjenerimi i raporteve të monitorimit nga Moduli BPPM, Menaxhimi i Portofolit të Planifikimit Buxhetor, seksioni "Raporte dhe Anekse" nga sistemi AFMIS, nuk ka funksionuar.

Për këtë qëllim, procesi i raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit 2026, nga ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore të MIE dhe njësitë shpenzuese të varësisë të MIE, ka vijuar me plotësimin e anekseve të monitorimit në formë manuale me të dhënat buxhetore dhe realizimin faktik të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) për periudhën raportuese të vitit 2026.

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik për 4 mujorin e dytë të vitit 2026, sipas klasifikimit ekonomik, paraqiten si në tabelën më poshtë:

në/lekë

Ministria e Infrastruktures dhe Energjise					
EMËRTIME		**Plani Fillestar Vjetor Viti 2026**	**Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026**	**Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive**	**% e realizimit**
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik					
Artikulli	Emërtimi				
600	Paga	1,722,306,000	1,742,540,424	1,090,884,133	63%
601	Sigurime Shoqërore	295,028,000	299,570,189	178,951,696	60%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,976,201,000	3,948,454,407	1,721,011,290	44%
603	Subvencione	850,000,000	850,000,000	368,120,507	43%
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0%
605	Transferta Korente të Huaja	47,000,000	49,900,000	38,795,204	78%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	85,272,000	90,451,980	57,319,237	63%
	Nën-Totali Shpenzime Korrente	**6,975,807,000**	**6,980,917,000**	**3,455,082,067**	**49%**
230	Kapitale të Patrupëzuara	900,532,000	857,072,203	159,080,935	19%
231	Kapitale të Trupëzuara	55,308,015,000	40,529,189,797	19,380,774,139	48%
	Nën-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	**56,208,547,000**	**41,386,262,000**	**19,539,855,074**	**47%**
230	Kapitale të Patrupëzuara	33,149,000	33,149,000	29,809,813	90%
231	Kapitale të Trupëzuara	14,037,875,000	13,087,875,000	4,196,275,590	38%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	**14,071,024,000**	**13,121,024,000**	**4,226,085,403**	**32%**
	Totali Shpenzime Kapitale	**70,279,571,000**	**54,507,286,000**	**23,765,940,477**	**44%**
	Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor	**77,255,378,000**	**61,488,203,000**	**27,221,022,544**	**44%**
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	**0**	**0**	**123,181,798**	**44%**

Për sa më lartë, rezulton se realizimi i fondeve buxhetore për 4 mujorin e dytë të vitit 2026 kundrejt planit të rishikuar të buxhetit 2026, është 44%. Krahasuar me realizimin e fondeve buxhetore për të njëjtën periudhë të vitit 2025, e cila ishte në masën prej 39%, evidentohet **një rritje e realizimit buxhetor prej 5%.**

Në nivel klasifikimi buxhetor, të dhënat krahasuese të realizimit buxhetor në % midis dy periudhave janë:

	4-mujori II 2025	4 mujori II 2026
✓ Shpenzimet korrente	48 %	49 %
✓ Shpenzime kapitale	38 %	44 %
nga të cilat :		
o *Shpenzime kapitale me financim të brendshëm*	*36 %*	*47 %*
o *Shpenzime kapitale me financim të huaj*	*44 %*	*32 %*

Realizimi buxhetor i shpenzimeve korrente, ka rritje në nivel plani dhe në nivel realizimi në vlerë nominale, dhe në % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

në/000 lekë

Shpenzimet Korrente	4-mujori II 2025	4 mujori II 2026
✓ Plani vjetor i rishikuar	6,711,161 lekë	6,980,917 lekë
✓ Realizimi buxhetor 4 mujor	3,213,703 lekë	3,455,082 lekë

Realizimi buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm ka rënie në nivel plani dhe rritje në nivel realizimi në vlerë nominale dhe në %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	4-mujori II 2025	4 mujori II 2026
✓ Plani vjetor i rishikuar	48,535,455 lekë	41,386,262 lekë
✓ Realizimi buxhetor 4 mujor	17,555,310 lekë	19,539,855 lekë

Realizimi buxhetor i shpenzimeve kapitale me financim të huaj ka rënie në nivel plani dhe në nivel realizimi si në vlerë nominale ashtu dhe në %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	4-mujori II 2025	4 mujori II 2026
✓ Plani vjetor i rishikuar	13,818,029 lekë	13,121,024 lekë
✓ Realizimi buxhetor 4 mujor	6,055,353 lekë	4,226,085 lekë

Lidhur me rialokimet buxhetore për 4-mujorin e dytë 2026, në nivel klasifikimi buxhetor japim shpjegimet si vijon:

- *Për shpenzimet korrente* është kërkuar nga MIE dhe është miratuar nga MF, 4 procedura buxhetore:

  - Miratuar nga Ministria e Financave, në muajin maj 2026, akordimi shtesë i fondit të veçantë, në vlerën 50,000 lekë, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" (të ndryshuar), për programin buxhetor "Planifikimi Urban".

  - Miratuar nga Ministria e Financave në muajin qershor 2026 :

- transferimi i fondit buxhetor në vlerën 483,321 lekë, për shpenzime operative në programin buxhetor "Planifikimi Urban";

- Miratuar nga Ministria e Financave në muajin korrik 2026 :
  - transferimi i fondit në vlerën 600,000 lekë, për shpenzime për transferta korrente të huaja, në programin buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore";
  - transferimi i fondit në vlerën 33,600,000 lekë, për shpenzime e personelit (paga dhe sigurime shoqerore), në programin buxhetor "Furnizimi me Uje dhe Kanalizime";

- Miratuar nga Ministria e Financave në muajin gusht 2026,
  - transferimi i fondit në vlerën 3,000,000 lekë, për shpenzime operative në programin buxhetor "Mbështetje për Industrinë";
  - transferimi i fondit në vlerën 5,340,066 lekë, për shpenzime operative në programin buxhetor "Planifikimi Urban";

- *Për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm* është kërkuar nga MIE dhe është miratuar nga MF, 2 procedura buxhetore:

  - Miratuar nga Ministria e Financave në muajin qershor 2026 :
    - transferimi i fondit buxhetor në vlerën 80,000 lekë, në programin buxhetor "Mbështetje për Energjinë";
    - transferimi i fondit buxhetor në vlerën 11,376,000 lekë, në programin buxhetor "Transporti Rrugor";

  - Miratuar nga Ministria e Financave në muajin korrik 2026 :
    - transferimi i fondit buxhetor në vlerën 5,843,200 lekë, në programin buxhetor "Transporti Hekurudhor";

- *Për shpenzimet kapitale me financim të huaj* është kërkuar nga MIE dhe është miratuar nga MF, 2 procedura buxhetore:

  - Miratuar nga Ministria e Financave në muajin qershor 2026 :
    - transferimi i fondit buxhetor në vlerën 200,000,000 lekë, në programin buxhetor "Transporti Hekurudhor";
    - transferimi i fondit buxhetor në vlerën 3,000,000 lekë, në programin buxhetor "Transporti Rrugor";

Në zbatim të ligjit 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", numri maksimal i punonjësve i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është 1338 punonjës.
Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"", numri maksimal i punonjësve buxhetore për sistemim MIE, është miratuar 1310 punonjës, duke pakësuar numrin e punonjësve të pashpërndarë për organikat e reja të pazbardhura, por të miratuara me ligjet përkatëse për 28 punonjës.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr.122, datë 19.06.2026 "Për miratimin e organigramës së Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil", numri i punonjësve buxhetore për këtë njësi shpenzuese është shtuar me 2 (dy) punonjës, duke vlerësuar se efekti shtesë i rritjes së numrit do të përballohej nga numri i pa shpërndarë për vitin 2026, sikurse është cituar edhe nga Ministria e Financave (shkresa nr.8427/1 prot, datë 02.06.2026).
Implementimi i kësaj strukture nuk u bë i mundur për shkak të AN nr.2 (si referuar më lart).

Në tabelën më poshtë paraqiten numri faktik i punonjësve për 4 mujorin e dytë të vitit 2026.

Entiteti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Llogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Numri i punonjësve buxhetore i miratuar për vitin 2026	Numri faktik i punonjësve buxhetore për 4 mujorin e dytë të vitit 2026
001	06	1006001	Aparati MIE	PN0000	3535	248	**200**
001	06	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar	PN0000	3535	212	**158**
001	06	1006067	Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastër)	PN0000	1111	41	**41**
001	06	1006077	Drejtoria e Rajonit Verior (Shkodër)	PN0000	3333	47	**47**
001	06	1006079	Drejtoria e Rajonit Qendër Perendim (Tiranë)	PN0000	3535	41	**37**
001	06	1006200	Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje (Korçë)	PN0000	1515	45	**41**
001	06	1006099	Instituti Transportit	PN0000	3535	15	**14**
001	06	1006100	Autoriteti Sigurisë Hekurudhore	PN0000	0707	15	**6**
001	06	1006205	Autoriteti Rregullator Hekurudhor	PN0000	3535	6	**1**
001	06	1006098	Drejtoria e Përgjithshme Detare	PN0000	0707	70	**66**
001	06	1006143	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil	PN0000	3535	8	**8**
001	06	1006047	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve	PN0000	3535	99	**97**
001	06	1006155	Agjencia Kombëtare Bërthamore	PN0000	3535	7	**7**
001	06	1006164	Agjencia e Efiçencës së Energjisë	PN0000	3535	25	**20**
001	06	1006156	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	PN0000	3535	116	**111**
001	06	1006158	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	PN0000	3535	47	**42**
001	06	1006203	Qendra Rajonale Inovacionit te Institucionit Evropian te Teknologjise dhe Inovacionit per Lendet e para	PN0000	0808	8	**6**
001	06	1006157	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial	PN0000	3535	199	**199**
001	06	1006159	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme	PN0000	0808	13	**11**
001	06	1006161	Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	PN0000	3535	21	**21**
001	06	1006187	Agjensia Shtetërore e Shpronësimeve	PN0000	3535	27	**24**
TOTALI						**1310**	**1157**

3. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PËRFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

Objekti i politikës së programit "Planifikimim, Menaxhim, Administrim", është mirëmenaxhimi i stafit të Aparatit MIE dhe politikëbërja me sukses brenda fushës së përgjegjësive shtetërore, duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe mos diskriminimin. Treguesit më kryesor të performancës me bazë gjinore renditen:

- ✓ Forcimi kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për punonjësit e administratës 55%
- ✓ Gra të përfaqësuara në nivele të larta drejtuese të Aparatit të MIE 15
- ✓ Raporti gra / ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE 135
- ✓ Raporti burra / ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE 65

Programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", përfshin si tregues të performancës rritjen e penetrimit dhe përdorimit të infrastrukturës digjitale broadband që i shërben përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore.

Në veçanti, projekti i parashikuar për investime në fibrat optike në zonat e bardha, parashikon të mbulojë me shërbime dhe infrastrukturë digjitale, zonat e pambuluara/pa shërbyera nga sektori privat duke rritur potencialisht mundësinë e përfshirjes sociale, të punësimit, dhe zvogëlimin të ndarjes digjitale gjinore. Gjithashtu projekti i parashikuar për sigurimin e mbulimit me Wi-Fi në zonat publike i shërben lehtësimit të aksesimit në TIK dhe shërbimet publike për të gjithë banorët/qytetarët në zonat e thella.

Referuar të dhënave më të fundit statistikore, shkalla e përdorimit të TIK, dhe në veçanti e Internetit në vend është si më poshtë:

- Përdorues të Internetit - Gjatë vitit 2025, 88,1 % e burrave dhe 86,3 % e grave të grup-moshës 16-74 vjeç janë përdorues të internetit "gjatë 3 muajve të fundit".
- Shpeshtësia e përdorimit të internetit sipas ndarjes gjinore, tregon se përdorimi i internetit "disa herë gjatë ditës" dominohet nga burrat me 50,3 %, ndërsa përdorimi i tij "çdo ditë" dominohet nga gratë me 53,3 %.
- Të punësuar në sektorin e telekomunikacionit - në vitin 2024 ndarja sipas gjinisë për të punësuarit në sektorin e telekomunikacionit ishte 31,2 % gra dhe 68,7 % burra. Gjatë periudhës së monitorimit nuk është e mundur të matet ndryshimi për këta tregues sepse jepet me bazë vjetore sipas të dhënave të raportuara nga AKEP, INSTAT.

4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1 PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.1.1 Programi Buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikim Menaxhim Administrim" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	756,544,000	757,054,367	388,889,518	51%
Shpenzime kapitale FB	12,000,000	12,000,000	357,600	3%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për periudhën raportuese me numër faktik 200 punonjës;

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar i vitit 2026 ka një rritje prej 510,367 lekë, që vjen nga akordimi fondit të veçantë dhe për periudhën raportuese jane likuiduar 3 raste dhënie ndihme fatkeqësie. Në ketë zë buxhetor për periudhën raportuese janë financuar për 468 dosje për dhënie ndihmë familjarëve për shpenzimet e shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptare që vdesin jashtë shtetit në zbatim të VKM nr.426, datë 09.07.1998 dhe udhëzimit nr.3912, datë 21.06.2004 "Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit".

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	231,102 lekë	239,035 lekë
Artikulli 601	37,278 lekë	38,795 lekë
Artikulli 602	18,375 lekë	21,585 lekë
Artikulli 605	35,314 lekë	34,270 lekë
Artikulli 606	33,150 lekë	55,203 lekë
TOTALI	**355,222 LEKË**	**388,889 LEKË**
REALIZIMI NË%	**48 %**	**51 %**

Në shpenzimet kapitale të programit ka realizim në produkte dhe në financim. Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 4,700,000 lekë ose 39% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 3 produkte si vijon:

- 1 projekt, procedura e prokurimit do të kryhet nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare;
- 2 projekte, në proces përgatitje dhe hartimi i termave të referencës.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	0 lekë	0 lekë
Artikulli 231	0 lekë	357 lekë
TOTALI	**0 LEKË**	**357 LEKË**
REALIZIMI NË%	**0%**	**3%**

4.1.2 Programi Buxhetor "Planifikimi Urban"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Planifikimi Urban", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**

Shpenzime korrente	102,333,000	102,453,000	62,647,091	61%
Shpenzime kapitale FB	104,000,000	71,815,000	6,547,469	9%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Nga zbatimi i Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2026", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u pakësuan me vlerën 32,285,000 lekë.

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit, me numër faktik 21 punonjës;
- ✓ Agjensia Shtetërore e Shpronësimeve, me numër faktik 24 punonjës

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar i vitit 2026 ka një rritje prej 120,000 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë.
Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale, ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	39,252 lekë	41,508 lekë
Artikulli 601	6,457 lekë	6,856 lekë
Artikulli 602	5,561 lekë	14,206 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	78 lekë	75 lekë
TOTALI	**51,351 LEKË**	**62,647 LEKË**
REALIZIMI NË%	**52 %**	**61%**

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit paraqitet si vijon në periudhat krahasuese, rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të ulët në vlerë nominale, ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	0 lekë	0 lekë
Artikulli 231	18,429 lekë	6,547 lekë
TOTALI	**18,429 LEKË**	**6,547 LEKË**
REALIZIMI NË%	**18%**	**9%**

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, me plan të shpenzimeve kapitale prej 68.3 milion lekë për implementimin e 2 projekteve dhe me realizim faktik në vlerën 4 milion lekë;
- ✓ Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve, me plan të shpenzimeve kapitale prej 3.4 milion lekë për implementimin e 3 projekteve dhe me një realizim faktik në vlerën 2,5 milion lekë;

Për një projekt të buxhetuar në vlerën 63,315,000 lekë ose 88% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 1 produkti, për të cilën është shpallur dhe po vijon procedura e prokurimit publik nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

4.1.3 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	0	0	0	0%
Shpenzime kapitale FB	50,000,000	5,000,000	0	0%
Shpenzime kapitale FH	20,000,000	20,000,000	0	0%

Në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm u pakësuan me vlerën 45,000,000 lekë.

Projektet kapitale paraqiten si më poshtë:

Gjatë 4 mujorit të dytë të vitit 2026 programi buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit" shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe shpenzimet kapitale me financim të huaj, nuk kanë realizim financiar për periudhën e raportimit

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm:

- Zhvillimi i rrjeteve 5G – Në zbatim të Marrëveshjes Shqipëri - Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë është i lidhur me zhvillimet e rrjeteve të së ardhmes dhe zbatimit të aplikacioneve digjtale, inovacionin për industrinë vertikale (energji, transport), qytetet e zgjuara (smart cities) dhe zhvillimet inovatore në ekonomi dhe shoqëri. Infrastruktura digjitale e shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë nënkupton rrjete me fibër optike dhe 5G. Për këtë qëllim që në vitin 2024 u licensuan rrjetet 5G në brezin 3.4-3.6 GHz dhe në vitin 2025 ka filluar ofrimi i shërbimeve 5G në këtë fazë të parë është evidentuar nevoja për kryerjen e një studimi për implementimin e Marrëveshjes Shqipëri-Kosovë mbi Autostradën Digjitale 5G Prishtinë-Tiranë, i cili nuk ka filluar ende.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj:

- WBIF-Investime në fibër optike në zonat e bardha, buxheti i rishikuar është në vlerën 20.000.000 lekë dhe realizimi financiar është në masën 0%, pasi projekti nuk ka filluar ende, pasi pritet të lidhet me përfundimin e asistencës teknike të WBIF.

4.1.4 Programi Buxhetor "Transporti Ajror"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Ajror", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	Plani rishikuar 2026	Realizimi në lekë	Realizimi në%
Shpenzime korrente	26,650,000	26,795,000	19,036,666	71%
Shpenzime kapitale FB	2,000,000	2,000,000	0	0%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026, ka pësuar ndryshim nga plani fillestar në vlerën 145,000 lekë nga akordimi i fondit të veçantë. Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu edhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	9,097 lekë	9,260 lekë
Artikulli 601	1,481 lekë	1,516 lekë
Artikulli 602	8,601 lekë	8,228 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	28 lekë	32 lekë
TOTALI	**19,209 LEKË**	**19,036 LEKË**
REALIZIMI NË%	**75%**	**71%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil me një numër faktik 8 punonjës.

Në shpenzimet kapitale të programit nuk ka realizim në produkte dhe në financim, kjo pasi janë miratuar projekte të reja për të cilat po hartohen termat e referencës dhe dokumentacioni teknik, me qëllim vijimin e procesit të prokurimit.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 231	0 lekë	0 lekë

4.1.5 Programi Buxhetor "Mbështetje për Industrinë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Industrinë", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**
Shpenzime korrente	394,433,000	395,154,200	250,319,138	63%
Shpenzime kapitale FB	57,750,000	57,750,000	16,403,773	28%
Shpenzime kapitale FH	0	0	0	0 %

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026 ka një rritje prej 721,200 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë dhe për periudhën raportuese janë likuiduar 2 raste dhënie ndihme ekonomike për fatkeqësi familjare.

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të lartë në vlerë nominale dhe të njëjtë në % me të njëjtën periudhë raportuese:

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**

Artikulli 600	188,739 lekë	197,114 lekë
Artikulli 601	31,303 lekë	32,722 lekë
Artikulli 602	17,765 lekë	20,027 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	149 lekë	455 lekë
TOTALI	**237,957 LEKË**	**250,319 LEKË**
REALIZIMI NË%	**63%**	**63%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të dy institucioneve të varësisë:

- ✓ Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, me një numër faktik 199 punonjës;
- ✓ Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, me një numër faktik 11 punonjës;

Realizimi i shpenzimeve kapitale të programit paraqitet si vijon në periudhat krahasuese. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të lartë në vlerë nominale dhe të ulët në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 231	15,199 lekë	16,403 lekë
REALIZIMI NË%	**75%**	**28%**

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga 4 njësi shpenzuese të varësisë si vijon. Për projektet që nuk kanë realizim financiar ende, po hartohen termat e referencës për të vijuar procedurat e prokurimit.

- ✓ Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, me një plan të shpenzimeve kapitale prej 35,1 milion lekë për implementimin e 1 projekti;
- ✓ Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, me një plan të shpenzimeve kapitale prej 3 milion lekë për implementimin e 2 projekteve;
- ✓ Uzina e Plehrave Azotike me një plan të shpenzimeve kapitale prej 9.6 milion lekë për fonde konservimi dhe për ruajtjen dhe monitorimin e 2 landfilleve të mbetjeve të rrezikshme dhe me realizim financiar në vlerën 6,4 milion lekë;
- ✓ Ndërmarrja e Prodhim Celiqeve Elbasan, me plan dhe realizim të shpenzimeve kapitale prej 10 milion lekë për fonde konservimi.

Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 38,100,000 lekë ose 66% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 3 produkte, për të cilat po vijon procedura e prokurimit publik nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

4.1.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**
Shpenzime korrente	365,005,000	365,875,000	202,054,730	55%
Shpenzime kapitale FB	97,000,000	97,000,000	53,258,399	55%
Shpenzime kapitale FH	30,585,000	30,585,000	8,070,525	26%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026 ka një rritje prej 870,000 lekë që vjen nga rialokimi i fondit të veçantë ku për periudhën raportuese janë likuiduar 2 raste dalje në pension, 1 rast dhënie ndihmë për ndërhyrje kirurgjikale dhe 3 raste dhënie ndihme e menjëhershme.

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të lartë në vlerë nominale dhe të njëjtë në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	144,718 lekë	148,501 lekë
Artikulli 601	23,295 lekë	23,506 lekë
Artikulli 602	24,639 lekë	27,161lekë
Artikulli 605	454 lekë	2,575 lekë
Artikulli 606	1,098 lekë	311 lekë
TOTALI	**194,207 LEKË**	**202,054 LEKË**
REALIZIMI NË%	**55%**	**55%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për aktivitetin operacional të tre institucioneve të varësisë:

- ✓ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me numër faktik 111 punonjës;
- ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera me numër faktik 42 punonjës;
- ✓ Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit të Lëndëve të para, me numër faktik 6 punonjës;

Si më poshtë vijon, përcjellim të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	35,518 lekë	31,887 lekë
Artikulli 231	29,305 lekë	21,371 lekë
TOTALI	**64,823 LEKË**	**53,258 LEKË**
REALIZIMI NË%	**67%**	**55%**

Shpenzimet kapitale të programit realizohen nga 7 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me plan të shpenzimeve kapitale prej 10 milion lekë për implementimin e 3 projekteve;
- ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, me plan të shpenzimeve kapitale prej 7.5 milion lekë për implementimin e 3 projekteve;
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me plan të shpenzimeve kapitale prej 45.1 milion lekë për implementimin e 7 projekteve;
- ✓ Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrine Nxjerrëse -EITI, me plan të shpenzimeve kapitale prej 16 milion lekë për funksionimin e aktivitetit;
- ✓ Shoqëria në konservim "Albakër" sh.a. me plan të shpenzimeve kapitale prej 6.3 milion lekë për fonde konservimi;
- ✓

- ✓ Shoqëria në konservim "Albminiera" sh.a. me plan të shpenzimeve kapitale prej 6.1 milion lekë për fonde konservimi;
- ✓ Shoqëria në konservim "Albkrom" sh.a. me plan të shpenzimeve kapitale prej 6 milion lekë për fonde konservimi;

- Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 14,528,000 lekë ose 45% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 5 produkte, si vijon:

- 1 projekt, është shpallur procedura për prokurim me marrëveshje kuadër;
- 3 projekte, po zhvillohen procedurat e prokurimit publik nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara;
- 1 projekt, në fazën e prokurimit nga AKSHI;për të cilat ka filluar procesi i përgatitjes së dokumentacionit për procedurën e prokurimit.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 231	0 lekë	8,070 lekë
REALIZIMI NË%	**0%**	**26%**

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga 2 njësi shpenzuese e varësisë si vijon:

- ✓ Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, me plan të shpenzimeve kapitale prej 17,9 milion lekë për implementimin e 2 projekteve.
- ✓ Qendra Rajonale Inovacionit te Institutit Evropian te Teknologjisë dhe Inovacionit për Lendet e Para me plan të shpenzimeve kapitale prej 13 milion lekë për implementimin e 2 projekteve.

4.1.7 Programi Buxhetor "Transporti Detar"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Detar", sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në %**
Shpenzime korrente	187,130,000	187,500,000	102,035,410	54%
Shpenzime kapitale FB	14,795,000,000	50,000,000	3,178,780	6%
Shpenzime kapitale FH	10,000,000	10,000,000	939,399	9%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026 ka një rritje prej 370,000 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë, ku për periudhën raportuese është realizuar 1 rast dalje në pension pleqërie dhe 1 rast ndihmë mjekësore.
Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim me të lartë në vlerë nominale ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	72,321 lekë	78,253 lekë
Artikulli 601	12,013 lekë	12,971 lekë
Artikulli 602	5,988lekë	8,516 lekë
Artikulli 605	0 lekë	1,950 lekë
Artikulli 606	173 lekë	343 lekë
TOTALI	**90,497 LEKË**	**102,035 LEKË**
REALIZIMI NË	**51%**	**54%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, me numer faktik 66 punonjës;

Në zbatim të Aktit Normativ nr.2 datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2026", shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit u pakësuan me vlerën 14,745,000,000 lekë.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit ka një realizim më të ulët në vlerë nominale dhe më të lartë në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 231	11,032 lekë	3,178 lekë
REALIZIMI NË%	**0.11%**	**6%**

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga 4 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 22.8 milion lekë për implementimin e 2 projekteve:
  - *Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport, Vlorë;*
  - *Kosto Lokale për projektet IPA;*
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 14.5 milion lekë për implementimin e 3 projekteve dhe 1.4 milion lekë për tvsh dhe kosto lokale për projekt IPA/Grant.
- ✓ Ndërrmarrja e Shfrytëzimit Ujor Vau Dejës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 4.9 milion lekë për fonde konservimi dhe realizim financiar në vlerën 3,178,780 lekë;

Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 11,578,000 lekë ose 23% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 2 produkte, si vijon:

- 2 projekte, po zhvillohen procedurat e prokurimit pranë Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu dhe në %, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 231	1,991 lekë	939 lekë
REALIZIMI NË%	**20%**	**9%**

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga 2 njësi shpenzuese e varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 5 milion lekë për implementimin e 2 projekteve:
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, me plan të shpenzimeve kapitale prej 5 milion lekë për implementimin e 3 projekteve.

Për programin buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore", janë evidentuar kërkesa për fonde shtesë si vijon:

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në vlerën 66,000,000 lekë;
- Albminiera sh.a, në vlerën 26,000,000 lekë;
- AlbKrom sh.a, në vlerën 13,900,000 lekë;

4.1.8 Programi Buxhetor "Mbështetje për Energjinë"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Mbështetje për Energjinë" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**
Shpenzime korrente	123,820,000	124,057,200	34,678,610	28%
Shpenzime kapitale FB	261,818,000	261,818,000	80,336,854	31%
Shpenzime kapitale FH	3,200,000,000	2,200,000,000	659,899,732	30%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026 ka një rritje prej 237,200 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në %.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	22,245 lekë	24,106 lekë
Artikulli 601	3,649 lekë	3,924 lekë
Artikulli 602	4,199 lekë	6,649 lekë
Artikulli 605	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	50 lekë	0 lekë
TOTALI	**30,443 LEKË**	**34,679 LEKË**
REALIZIMI NË%	**25%**	**28 %**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të 3 njësive shpenzuese të varësisë:

- ✓ Agjencia Kombëtare Bërthamore me numër faktik 7 punonjës;
- ✓ Agjencia e Efiçencës së Energjisë, me numër faktik 20 punonjës;
- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (shpenzime arbitrazhi);

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit, ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	27,746 lekë	41,714 lekë
Artikulli 231	113,731 lekë	38,622 lekë
TOTALI	**141,477 LEKË**	**80,336 LEKË**
REALIZIMI NË%	**57%**	**31%**

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga 4 njësi shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 21.8 milion lekë për implementimin e bashkëfinancimit dhe tvsh të projekteve IPA;
- ✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me plan të shpenzimeve kapitale prej 20 milion lekë për implementimin e 8 projekteve;
- ✓ Agjencia e Efiçencës së Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 220 milion lekë për implementimin e 21 projekteve të eficencës së energjisë;

Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 134,505,879 lekë ose 51% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 16 produkte, janë projekte në fushën e energjisë të cilat janë dërguar për oponencë teknike tek Instituti i Ndërtimit në muajin gusht 2026 dhe me përfundimin e procesit, do të përcillen te Operatori i Blerjeve të Përqëndruara për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale, ashtu dhe në % krahasuar me të njëjtën periudhë referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 231	1,031,792 lekë	659,899 lekë
REALIZIMI NË%	**34%**	**30%**

Me Aktin Normativ nr.2, datë 30.06.2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"", shpenzimet kapitale me financim të huaj, u pakësuan me vlerën 1,000,000,000 lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga disa njësi shpenzuese si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për implementimin e 2 projekteve;
  - o *Konvikte të rinovuara me eficence te energjise (Faza e dyte) Qyteti Studentit nr 1, grant dhe kredi;*
  - o *Transporti i Gjelbër;*
- ✓ Shoqëria KEsh sha (PIU), për implementimin e 2 projekteve

- *Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKT);*
- *Projekti PV Belshi;*

✓ Shoqëria OSHEE Grop sha, për implementimin e 7 projekteve;
- *Ndërtimi i Nënstacionit Kamëz(Valias) me fuqi 2x40MV (ONAN/ONAF) 110/20KVA dhe ndërtimi i dy fiderave 20kV (V4, V5P);*
- *Rehabiltimi i rrjetit Himarë – Dhërmi;*
- *Programi i Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I (Kredi dhe Grant);*
- *SCADA (Zgjerimi i sistemit SCADA ne godinen Qendrore te OSHEE);*
- *Rikonstruksioni i Nënstacioneve 110kV në rajonet (Tiranë, Durrës dhe integrimi i tyre në sistemin Scada;*
- *Instalimi i matësave inteligjent dhe balancimi në pikat e transformimit, si dhe sistemi CRM/Billing (ERP), Faza I;*
- *Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit të vitit 2019 (Hua CDP);*

✓ Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për implementimin e 3 projekteve IPA;

✓ Sekretariati i nismes për Transparence ne Industrine Nxjerrese (EITI)
- *Mbështetje për vazhdimësinë për nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse EITI;*

4.1.9 Programi Buxhetor "Transporti Rrugor"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Rrugor" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

lekë

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**
Shpenzime korrente	3,980,922,000	3,982,914,033	1,883,059,216	47%
Shpenzime kapitale FB	27,707,766,000	27,707,766,000	15,473,871,822	56%
Shpenzime kapitale FH	3,698,323,000	3,698,323,000	1,780,555,000	48%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026 ka një rritje prej 1,992,033 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë ku për periudhën raportuese janë likuiduar 11 raste dalje në pension pleqërie dhe 2 raste dhënie ndihmë fatkeqësie.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të lartë në vlerë nominale, por më të ulët në % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	201,458	243,449
Artikulli 601	33,528	40,616
Artikulli 602	1,557,899	1,598,140
Artikulli 605	0	0
Artikulli 606	754	853
TOTALI	**1,793,641**	**1,883,059**
REALIZIMI NË%	**49%**	**47%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të njësive shpenzuese si vijon:

- ✓ Autoriteti Rrugor Shqiptar me numër faktik 158 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Qendër Perëndim Tiranë me numër faktik 37 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër me numër faktik 47 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër, me numër faktik 41 punonjës;
- ✓ Drejtoria e Rajonit Qendër Lindje Korçë me numër faktik 41 punonjës;
- ✓ Instituti i Transportit me numër faktik 14 punonjës;

Artikulli 602 përmban jo vetëm shpenzimet e administrimit për njësitë shpenzuese të sipërcituara, por edhe shpenzimet e kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve.

ARRSH administron një rrjet rrugor prej 3499 km nga të cilat:
- ✓ 1225 km janë rrugë primare dhe mirëmbahen me 4 kontrata mirëmbajtje;
- ✓ 2234 km janë rrugë sekondare që mirëmbahen me 48 kontrata mirëmbajtje;

Buxheti i rishikuar për vitin 2026 për kontratat e mirëmbajtjes është në vlerën 3,229,987,000 lekë dhe realizimi financiar për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 është në vlerën 1,431,445,146 lekë ose 44% e planit.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit për 4 mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu edhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	12,849	39,995
Artikulli 231	11,607,117	15,433,876
TOTALI	**11,619,966**	**15,473,871**
REALIZIMI NË%	**44%**	**56%**

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga njësitë shpenzuese të varësisë si vijon:

- ✓ Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me plan të shpenzimeve kapitale prej 5,3 miliard lekë për implementimin e projekteve koncensionare të infrastrukturës rrugore;
- ✓ Autoriteti Rrugor Shqiptar, me plan të shpenzimeve kapitale prej 22,3 miliard lekë për implementimin e projekteve infrastrukturore;
- ✓ Instituti Studimeve të Transportit, me plan të shpenzimeve kapitale prej 3 milion lekë;

Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 3,723,674,353 leke lekë ose 13% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 54 produkte, nga të cilat:

- 30 projekte janë projekte investimesh, studim projektime dhe sinjalistikë rrugore;
- 24 projekte janë supervizion punimesh;

Nga këto po raportojmë ecurinë e procedurave të prokurimit, si vijon:

- ✓ 1 projekt, anulluar procedura, në proces rishpallje procedurë;
- ✓ 1 projekt, është bërë kërkesë AKSHI për shpalljen e procedurës së prokurimit;
- ✓ 1 projekt, është dërguar pranë APP për publikim;
- ✓ 23 projekte, në proces hartimi i termave të references dhe fondit limit;
- ✓ 4 projekte, në afatet e vlerësimit të ofertave dhe ankimit;
- ✓ 2 projekte, është shpallur fituesi nga AKSHI dhe pritet lidhja e kontratës;

- ✓ 2 projekte, hartuar rregjistri i parashikimit;
- ✓ 18 projekte, në proces vlerësimi dokumentacioni;
- ✓ 2 projekte, është shpallur fituesi dhe është për ankimin ne KPP;

Për periudhën raportuese të 4 mujorit të dytë të vitit 2026, në sasi produkti 13 projekte të reja kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces lidhje kontrate.Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit për 4 mujorin e dytë të vitit 2026, ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	33,594	0
Artikulli 231	1,608,119	1,780,555
TOTALI	**1,641,714 LEKË**	**1,780,555**
REALIZIMI NË%	**46%**	**48%**

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Njësitë e menaxhimit të projekteve të huaja:

- ✓ Përmirësimi dhe rehabilitimi i Urave (Financim i Bankës Botërore);
- ✓ Ndërtim segmenti rrugor Qukës – Qafë Pllocë Loti 1, Loti 2, Loti 3;
- ✓ Ndërtim By pass Tirana;
- ✓ Studim projektime për Urën e Vjosës, Beshirit, urën e grupit A dhe urën e grupit B;

4.1.10 Programi Buxhetor "Transporti Hekurudhor"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Transporti Hekurudhor" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**
Shpenzime korrente	538,600,000	538,600,000	361,619,750	67%
Shpenzime kapitale FB	1,300,000,000	1,300,000,000	99,854,683	8%
Shpenzime kapitale FH	4,599,202,000	4,599,202,000	500,675,399	11%

Në shpenzimet korrente të programit, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 realizimi financiar është më i lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në % me periudhën karahasuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	8,609 lekë	9,471 lekë
Artikulli 601	1,328 lekë	1,454 lekë
Artikulli 602	58 lekë	118 lekë
Artikulli 603	0 lekë	0 lekë
Artikulli 606	305,118 lekë	350,530 lekë
TOTALI	**337,257 LEKË**	**361,619 LEKË**
REALIZIMI NË%	**61%**	**67%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të njësive shpenzuese si vijon:

- ✓ Autoriteti Sigurisë Hekurudhore, me numër faktik 6 punonjës;
- ✓ Autoriteti Rregullator Hekurudhor, me numër faktik 1 punonjës;
- ✓ Hekurudha Shqiptare Sh.A e cila administron fondin buxhetor të artikullit 603 "Subvencione";

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 rezulton më i ulët si në vlerë nominale ashtu dhe në % krahasuar me periudhën krahasuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	39,589 lekë	0 lekë
Artikulli 231	297,668 lekë	99,854 lekë
TOTALI	**337,257 LEKË**	**99,854 LEKË**
REALIZIMI NË%	**61%**	**8%**

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga shoqëria Hekurudha Shqiptare sha

- ✓ 2 projekte për studim projektim të buxhetuara në vlerën 55 milion lekë;
- ✓ 9 projekte për mirëmbajtje të ndryshme dhe rinovime të trungut hekurudhor të buxhetuara në vlerën 995 milion lekë;
- ✓ TVSH për projektet me financim të huaj të programit të buxhetuara në vlerën 244.1 milion lekë;

Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 836,540,000 lekë ose 64% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 9 produkte, nga të cilat :

- Për 1 projekt, procedura e prokurimit u anullua dhe pritet të rihapet përsëri;
- Për 1 projekt, është nënshkruar kontrata dhe po vijon puna për hartimin e projektit;
- Për 1 projekt, është shpallur fituesi dhe pritet të nënshkruhet kontrata;
- Për 1 projekt, ka përfunduar përllogaritja e fondit limit dhe po vijohet me fazën e prokurimit;
- Për 1 projekt, procedura e prokurimit për këtë projekt është në fazën e ankimimit ne KPP;
- Për 4 projekte, po vijojnë procedurat e prokurimit publik.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale ashtu dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	0 lekë	29,809 lekë
Artikulli 231	1,627,574 lekë	470,865 lekë
TOTALI	**1,627,574 LEKË**	**500,675 LEKË**
REALIZIMI NË%	**33 %**	**11%**

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga shoqëria "Hekurudha Shqiptare", sha, permendim projektet si vijon :

- ✓

- ✓ Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Terminali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë- Rinas 2;
- ✓ Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë-Hani i Hotit";
- ✓ Zbatimi i projektit inxhinierik dhe arkitektonik i godinave të stacioneve hekurudhore Durrës-Tiranë TTP-Rinas Aeroport;
- ✓ Zbatimin e punimeve ndërtimore për elektrifikimin e linjës hekurudhore Durrës-Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit;
- ✓ Hartimi i projektit të detajuar Rrogozhinë–Pogradec;

4.1.11 Programi Buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"

Realizimi financiar i programit buxhetor "Furnizimi me ujë dhe Kanalizime" sipas burimit të financimit dhe në nivel klasifikimi buxhetor rezulton të jetë:

lekë

	Plani fillestar 2026	**Plani rishikuar 2026**	**Realizimi në lekë**	**Realizimi në%**
Shpenzime korrente	500,370,000	500,514,200	150,741,938	30%
Shpenzime kapitale FB	11,821,213,000	11,821,213,000	3,806,045,694	32%
Shpenzime kapitale FH	2,512,914,000	2,512,914,000	1,275,944,961	50%

Në shpenzimet korrente të programit, plani i rishikuar 2026 ka një rritje prej 144,200 lekë që vjen nga akordimi i fondit të veçantë.

Si më poshtë vijon, paraqiten të dhënat krahasuese për realizimin financiar për të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rezulton se për 4-mujorin e dytë të vitit 2026 ka një realizim më të lartë si në vlerë nominale ashtu dhe në % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Korrente	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 600	100,559	100,184
Artikulli 601	16,469	16,588
Artikulli 602	8,915	16,378
Artikulli 603		17,590
Artikulli 606	113	0
TOTALI	**126,057 LEKË**	**150,741**
REALIZIMI NË%	**20%**	**30%**

Shpenzimet korrente në program shërbëjnë për mirëfunksionimin e aktivitetit operacional të Agjensisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe strukturës Task Forcë të ngritur brenda kësaj njësie shpenzuese.

AKUK administron dhe shpenzimet e artikullit 603 "Subvencion". Këto shpenzime përdoren në zbatim të udhëzimit respektiv të Ministrit të Infrastruktrës dhe Energjisë në kuadër të rritjes së performancës financiare të shoqërive ujësjellës kanalizimeve të krijuara në kuadër të reformës së ujit.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm të programit për 4 mujorin e dytë të vitit 2026 rezulton me një realizim më të ulët si në vlerë nominale, ashtu edhe në %, krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FB	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	219,510	45,483
Artikulli 231	5,127,613	3,760,561
TOTALI	**5,347,123**	**3,806,045**
REALIZIMI NË%	**47%**	**32%**

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm të programit realizohen nga Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve të krijuara nga Reforma e Ujit me nënzërat si vijon:

- ✓ Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe rikonstruksion rrjeti;
  - *Sasia (sipas planit fillestar vjetor) 1.033.972 ml;*
  - *Sasia (sipas /periudhës raportuese të vitit korent) 183,281 ml;*

- ✓ Ndërtim rrjet kanalizimi dhe ITUN dhe rikonstruksion rrjeti;
  - *Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) 73.629 ml;*
  - *Sasia (sipas /periudhës raportuese të vitit korent) 22,421 ml;*

Projektet e reja të buxhetuara në vlerën 3,141,041,322 lekë ose 26% të tavanit buxhetor të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, në sasi 101 produkte nga të cilat:

- 69 projekte janë projekte investimesh;
- 32 projekte janë supervizion punimesh;

Nga këto po raportojmë ecurinë e procedurave të prokurimit, si vijon:

- ✓ 12 projekte, nuk ka filluar procesi i prokurimit;
- ✓ 20 projekte, në proces përgatitje dokumentacioni teknik për prokurim;
- ✓ 18 projekte, janë hapur ofertat dhe proces vlerësimi;
- ✓ 2 projekte, kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe pritet njoftimi i fituesit;
- ✓ 8 projekte, në fazë ankimi;
- ✓ 6 projekte, në fazë ankimi pritet vendimi i KPP;

Për periudhën raportuese të 4 mujorit të dytë të vitit 2026, në sasi produkti 35 projekte të reja kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces lidhje kontrate.

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj të programit ka një realizim më të ulët si në vlerë nominale, ashtu dhe në % krahasuar me periudhën referuese të vitit 2025.

në / 000 lekë

Shpenzimet Kapitale FH	Realizimi Financiar **Viti 2025**	Realizimi Financiar **Viti 2026**
Artikulli 230	0	0
Artikulli 231	1,752,281	1,275,944
TOTALI	**1,752,281**	**1,275,944**
REALIZIMI NË%	**79%**	**50%**

Shpenzimet kapitale me financim të huaj të programit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe njësitë e menaxhimit të projekteve në AKUK, si vijon:

- ✓ Infrastruktura Bashkiake V (Kredi dhe Grant), faza II;
- ✓ Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve;
- ✓ Projekti i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm për ujësjellësin e Bashkisë Durrës (Kredi dhe Grant);
- ✓ Projekti i kanalizimeve Tirana e Madhe;

4.2 PERFORMANCA JO FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

4.2.1 Programi Buxhetor "Planifikim menaxhim Administrim"

Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim" ka si objektiv funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore, krijimin e një stafi permanent dhe sa më të qëndrueshëm, aplikimin e proceseve transparente të konkurimit në përputhje me parimet e barazisë gjinore, motivimin për ngritjen në detyrë sipas rezultateve, me qëllim rritjen e standardeve dhe performancës së punës.

Qëllimi i programit është mirëmenaxhimi i stafit të aparatit të MIE-së dhe politikbërja me sukses brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucionit duke respektuar parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin.

Treguesit e performancës në këtë program janë:

✓ Forcimi kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për punonjësit e Administrates	55%
✓ Numri i grave të përfaqësuara në nivele të larta drejtuese të Aparatit të MIE	15
✓ Raporti i numrit të grave ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE	135
✓ Raporti i numrit të burrave ndaj totalit të punonjësve të Aparatit të MIE	65

4.2.2 Programi Buxhetor "Planifikimi Urban"

Ky program harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin. Ka për qëllim ndër të tjera të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit; të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar, rajonal e vendor; të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës; të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta, të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë dy institucione varësie:

1. Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit (AQTN), që mbledh, përpunon, administron, ruan dhe shërben pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Kjo pasuri është dokumentacion teknik me vlera shkencore, teorike e praktike, në fushën e ndërtimit, me interes historik kombëtar dhe është pjesë e Fondit Arkivor Kombëtar Shqiptar (F A K SH).
2. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH), funksioni i së cilës është të garantojë që procedurat e shpronësimit ose të marrjes në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të personave fizikë ose juridikë privatë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë të realizohen në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në bashkërendim me çdo sektor;
- Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- Mundëson kushte të përshtatshme për stafin i cili merret me cështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

- Përmirëson kuadrin ligjor në fushën e projektimit;

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e territorit;
- Kryerja e procesit mbi rikualifikimin urban të zonave përmes projektesh pilot, urbanizimi dhe integrimi;
- Hartimin e rregullave dhe standarteve të projektimit në fushat e projektimit të universiteteve dhe ambjentet ndihmëse të tyre;
- Dixhitalizimin e dokumentave që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- Ruajtjen e te drejtës së pronësisë për cdo individ;

4.2.3 Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

Programi Buxhetor "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", është një nga programet prioritare të fushës së përgjegjësisë së MIE. Objektivat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfshijnë dhe politikat e përgjithshme shtetërore në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, për hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë;

Gjatë periudhës raportuese, ka filluar puna për zbatimin e ligjit nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", me hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri, identifikimi i masave/reformave prioritare që janë pjesë e planit të ri të rritjes në lidhje me infrastrukturën digjitale, rrjetet 5G dhe plotësimi i rekrutimeve të specialistëve në sektorin e BCO të krijuar si pjesë e drejtorisë. Në fokusin e punës ka qenë zbatimi i planit kombëtar të broadband, ndjekja e angazhimeve të integrimit evropian dhe promovimi i pjesëmarrjes në Programin Digjital të BE-së.

Programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit", përfshin si tregues të performancës rritjen e penetrimit dhe përdorimit të infrastrukturës digjitale broadband që i shërben përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore.

Në veçanti, projekti i parashikuar për investime në fibrat optike në zonat e bardha, parashikon të mbulojë me shërbime dhe infrastrukturë digjitale, zonat e pambuluara/pa shërbyera nga sektori privat duke rritur potencialisht mundësinë e përfshirjes sociale, të punësimit, dhe zvogëlimin të ndarjes digjitale gjinore.

4.2.4 Programi Buxhetor "Transporti Ajror"

Programi buxhetor "Transporti Ajror", merret me hartimin e politikave zhvilluese të transportit ajror që synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar gjetjen e burime të ndryshme financuese dhe investuese për infrastrukturën aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues në shërbimet ajrore.

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil është themeluar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 2, e 101, të ligjit 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë". Autoriteti i Investigimit ka si mision përmirësimin e sigurisë ajrore dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve, nëpërmjet investigimit të tyre dhe nxjerrjes së shkaqeve, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Investigimi i aksidenteve dhe i incidenteve të rënda kryhet nga AKISA (safety) në Aviacionin Civil, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për transportin.

Qëllimet e Politikës së Programit: Integrimi i aviacionit civil shqiptar në sistemet evropiane të transportit ajror në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektivat dhe produktet të cilat synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht janë të lidhur me:

- zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara;
- rritjen e standardeve dhe performancës së Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve;

4.2.5 Programi Buxhetor "Mbështetje për Industrinë"

Programi "Mbështetje për Industrinë" ka për qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion, eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë:

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili ushtron një veprimtari të gjerë, të shtrirë në të gjithë territorin e vendit për inspektimin, zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore e nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe të sigurimit të punës për instalimet, pajisjet nën presion, për pajisjet dhe instalimet elektrike dhe të sistemeve të gazifikimit dhe impianteve kombëtare.
2. Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit te Kimikateve të Rrezikshme ka për mision reduktimin e rrezikut të ndotjes të mjedisit dhe dëmtimit të shëndetit të njerëzve nga keqpërdorimi apo trafikimi për përfitime të paligjshme i kimikateve të rrezikshme,të mbetura në kushte të pasigurta depozitimi dhe ruajtjeje në magazinat apo ambientet e ish-nderrmarrjeve dhe subjekteve publike të fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Nxitjen e interesit për investime të biznesit vendas dhe të huaj në zhvillimin e veprimtarisë industriale;
- Rritjen e nivelit të sigurisë së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të produkteve, pajisjeve, instalimeve industriale, instalimeve elektrike dhe pajisjeve nën presion.
- Eliminimin e rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme gjendje në kushte të pa sigurta depozitimi dhe ruajtjeje në magazinat apo ambientet e ish ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve publike.

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Sigurimi i kushteve për monitorimin e standarteve teknike në fushën e hidrokarbureve, minierave dhe industrisë, për problemet e sigurisë së produkteve/pajisjeve/instalimeve dhe në tërësi veprimtarisë

  industriale në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit si dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.
- Krijimi i kushteve për miradministrimin e kimikateve të trashëguara dhe dy landfilleve në të cilat janë depozituar mbetjet e rrezikshme si dhe konservimi dhe mbyllja e ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s.
- Eliminimi i rrezikut të dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme të papërdorshme, në gjendje e në kushte të pa sigurta depozitimi.

4.2.6 Programi Buxhetor "Mbështetje për Burimet Natyrore"

Ky program harton, mbështet dhe zbaton proceset dhe politikat për burimet natyrore. Programi ka për qëllim identifikimimin e mundësive për një zhvillim të qëndrueshëm në sektorin minerar, nëpërmjet realizimit të politikave të promovimit, mbikqyrjes, monitorimeve si dhe transparencës.

Pjesë e aktiviteteve të këtij programi janë edhe dy institucione varesie:

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar i cili ka si objektiv evidentimin e resurseve të burimeve natyrore minerare, hidrokarbure dhe hidrologjike me qëllim nxitjen e shfrytëzimit maksimal, zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të informacionit, bankës së të dhënave për të mundësuar transmetimin në kohë të informacionit drejt vendim-marrësve, si dhe parandalimin e rreziqeve gjeologo-mjedisore, hidrologjike, nëpërmjet kryerjes së studimeve dhe analizave paraprake në mbështetje të pushtetit qëndror dhe lokal.
2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat ne Miniera (AKSEM), i cili kryen veprimtari inspektimi në fushën e sigurisë në punë, të emergjencave dhe të shpëtimit në veprimtarinë minerare dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike.

Politikat e këtij programi synojnë:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara të mineraleve të kromit, bakrit dhe ranor silicor, vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare, hartimi i studimeve dhe projekteve gjeologjike, studimi dhe vlerësimi i pasurive natyrore të lëndëve hidroenergjetike. Vlerësimin e rreziqeve gjeologjike mbi qëndrueshmërine e truallit dhe infrastrukturës publike në shkallë vendi dhe vlerësime emergjente. Mirëadministrimi i territorit në shkallë vendi, nëpërmjet përpilimit të hartave gjeologjike, gjeomjedisore gjeomonumenteve.
- Shfrytëzimin me eficencë i burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko - profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane.
- Rritjen e transparencës në industrinë nxjerrëse, me qëllim rritjen e cilësisë në mirëqeverisjen e industrisë nxjerrëse.

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Promovimin e burimeve të pashfrytëzuara.
- Përmirësimi i standarteve në kuadër të sigurisë në miniera dhe ndërhyrjeve shpëtuese.
- Shfrytëzimi me eficencë i burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari.
- Rritja e transparencës në industrinë nxjerrëse.

4.2.7 Programi Buxhetor "Transporti Detar"

Programi buxhetor "Transporti Detar", ka për qëllim zhvillimin e Shqiperisë nga një vend bregdetar, në një vend të zhvilluar detar orientuar drejt rritjes ekonomike e integrimit europian, nëpërmjet përmiresimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte. Objektivi i këtij programi është kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale duke sjellë një rritje të investimeve do të shërbej në zhvillimin e Shqipërisë, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

4.2.8 Programi Buxhetor "Mbështetje për Energjinë"

Qëllimi i politikës së programit, ka për qëllim të nxisë rritjen e sektorit energjitik përmes mbështetjes buxhetore, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale. Programi mbështetet me fonde buxhetore të nevojshme, për zbatimin e politikave në fushën e energjisë, elektroenergjitike, energjisë së rinovueshme, eficencës së energjisë, hidrokarbureve.

Programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", konsiston në :

- Zhvillimin e mëtejshëm të burimeve të qëndrueshme të energjisë, përdorimit efiçient të tyre, rritjen ekonomike të shoqëruar me sisteme të integruara rajonale dhe kombëtare të energjisë;

- Diversifikimin e burimeve të energjisë, bazuar në parimet e tregut dhe në përputhje me kërkesën për energji, për zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.
- Implementimi i politikave dhe strategjive në zbatim të programit dhe prioriteteve të Qeverisë, si dhe përmbushjen e angazhimeve, në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë e Direktivave të BE.
- Mbështetje e politikave, në kuadrin ligjor, nënligjor dhe institucional në sektorin energjetik dhe mbështetjen e mëtejshme, për krijimin e kushteve për nxitjen dhe hapjen e tregut energjetik në përputhje me paketën e tretë rregullatore të BE.

4.2.9 Programi Buxhetor "Transporti Rrugor"

Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, programi buxhetor mbështet :

- Zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar të transportit;
- Përfundimi i akseve të Koridorit VIII dhe të Koridorit Blu, projekte të cilat kanë filluar të ndërtohen dhe janë në listën e Projekteve Strategjike Kombëtare
- Përmirësimin e qëndrueshmërisë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e infrastrukturës rrugore me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Financimin për projektet që sigurojnë zgjerimin, rritjen e standardeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm;

Qëllimi i Politikës së programit është:

- Të krijohen parakushtet për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë;
- Të rritet aksesi i mallrave dhe udhëtarëve në tregti dhe ofrimin e shërbimeve;
- Të kontribohet në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e përgjithshme dhe zhvillimin e ekonomisë;
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të rrugëve nacionale, për të ruajtur investimet e realizuara në infrastrukturën rrugore.

4.2.10 Programi Buxhetor "Transporti Hekurudhor"

Qëllimi i politikës së programit, është integrimi i sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe evropian në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional.

Objektiva të programit janë:

- Ruajtja e mjedisit të gjelbër dhe ndërlidhës, në përputhje me objektivat strategjik për zhvillim dhe integrim të Shqipërisë, në sektorin e transportin;
- Transformimi i nivelit teknik në sistemin hekurudhor, duke garantuar sigurinë në lëvizje dhe rritje të performancës në lëvizje të trenave;
- Përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore dhe disponibilitetin e mjeteve hekurudhore;
- Ulja e numrit të aksidenteve;
- Rritja e shpejtësisë mesatare të lëvizjes së trenave kundrejt 30 km/orë;

Prioriteti kryesor në fushën e transportit hekurudhor ka qenë dhe mbetet "Reformimi i sektorit hekurudhor për të krijuar një treg të hapur për publikun dhe investitorët privatë".

4.2.11 Programi Buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"

Qëllimi i politikës së programit, është reformimi i sektorit të Ujesjellës-Kanalizimeve, i cili është prioritet i Qeverisë Shqiptare, në përmbushje të vizionit të Strategjisë Kombëtare për një sistem të besueshëm

mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime që plotëson nevojat e një ekonomie në zhvillim, bazuar në :

- Furnizim me ujë të zonave urbane;
- Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare;
- Furnizimin me ujë të zonave rurale;
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performancës së Shoqërive të reja Rajonale;
- Mbulimin me Kanalizime dhe ITUN

Disa prej kompetencave që ushtron AKUK janë si në vijim:

a) Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin / rehabilitimin / zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale.

b) Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të ITUN-eve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare.

c) Koordinon nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë e ofron këshillime gjatë proçesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. Përgatit, gjithashtu, projekte zhvillimore dhe projekte pilot, me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera të administratës publike.

d) Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e proçedurave e të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë.

4.3 VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR

Veprimet vijuese lidhen me realizimin e buxhetit për vitin 2026, në nivele maksimale për 11 programet buxhetore të MIE. Për 4 mujorin e dytë të vitit 2026, të gjitha projekte e reja të investimeve kapitale po vijojnë me procedurat prokurimit, ku pritshmeritë e realizimit të tyre deri në fund të vitit buxhetor janë të larta.

5. PROJEKTET KAPITALE

Projektet kapitale prioritare të cilat po implementohen nga MIE, sipas programeve buxhetore, me financim nga buxheti i shtetit dhe me financim të huaj, përmendim:

Tavani buxhetor i programit buxhetor "Transporti Rrugor", përbën 58% të totalit të buxhetit të rishikuar të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 67% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- Zbatimi dhe financimi i projekteve koncesionare të infrastrukturës rrugore të MIE:
  - Ndërtim, operim, mirëmbajtje Rruga e Arbrit;
  - Ndërtim, operim, mirëmbajtje Rruga Orikum-Dukat- Porti I Jahteve;
  - Ndërtim, operim mirëmbajtje rruga Milot- Morinë;

- Zbatimi dhe financimi i projekteve të infrastrukturës rrugore nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ndahen në:

✓ Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2), Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 9,894,630,862 lekë ose 50% ndaj planit total dhe në sasi 12.7 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 5,381,502,197 lekë ose 55% e buxhetit të planifikuar.
Përfshihen në këtë grup rruge:
Ndërtim i Unazës së jashtme Tiranë, Loti 7;
Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti1 dhe QMT;
Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës Faza I, Faza II, Faza III;
Plotësimi i punimeve dhe përmirësimi estetik nga sheshi shqiponja deri te nënkalimi i Limuthit.
Ndërtim aksi rrugor Elbasan - Papërr Faza I, II (modifik kontrate) Faza III;
Ndërtim aksi rrugor Papërr - Ura e Grykshit, Faza I, Faza II, Faza III;
Ndërtim rruga Kashar - Nyja Vaqarr Faza I, Faza II;
Ndërtim rruga lidhëse Tiranë - Elbasan me korridorin VIII, Faza I dhe Faza II;

✓ Ndërtim rruge tip B me dy korsi. Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 5,594,441,172 lekë dhe në sasi 16.14 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 3,797,425,111 lekë ose 68% e buxhetit të planifikuar.
Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara:

- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza II)+modifikim kontrate;
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza III);
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza IV);
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza V) + modifikim kontrate;
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza VI) + modifikim kontrate;
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza VII);
- Zgjerimi i rrugës Elbasan - Qafë - Thanë (Faza VIII);
- Rehabilitimi i rrugës Fier - Kthesa e Patosit – Frataj;
- Ndërtim rruga kthesa e Bërdicës - Ura e Bahcallëkut;

✓ Ndërtim rruge tip C2 me dy korsi, janë planifikuar fonde në vlerën 4,554,466,835 lekë ose 23% ndaj planit vjetor dhe në sasi 85.27 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është në vlerën 1,952,143,453 lekë ose 43% e buxhetit të planifikuar dhe në sasi 17.73 km ose 21% e sasisë së planifikuar. Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.
Po punohet normalisht në projektet si vijon:

- Ndërtim rruga Palasë – Dhërmi+ modifikim kontrate;
- Sistemim asfaltim rruga Qafa e Buallit – Martanesh;
- Plotësim i punimeve rruga Qafa e Buallit – Martanesh;
- Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 1, Loti 2, Loti 3;
- Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat- Ndroq - Plepa, Loti 1+modifikim kontrate, Loti 2, Loti 3;
- Zgjerimi i rrugës së Ksamilit;
- Ndërtim i rrugëve lidhëse me Tunelin e Llogarasë;
- Ndërtim By Pass Sarandë, Faza I;
- Ndërtim i rrugës lidhëse të unazës verilindore me rrugën e Arbërit;
- Rehabilitimi i segmentit rrugor Shijan -Delvinë dhe rruga lidhëse e fshatit Vergo, ndriçimi i rrethrrotullimit të Shijanit;
- Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër;
- Sistemim asfaltim rrugët e Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje (Korçë);
- Ndërtim- Projektim “Rruga "Çarja e Zaltës"- rruga "Kasem Caushi"- "Kostandin Kristoforidhi" dhe "17 Nëntori" me rrugën dytësore të autostradës Tiranë-Durrës" si dhe nëpërmjet rrugës "Tre Dëshmorët" me rrugën "Konferenca e Pezës";

- ✓ Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore. Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerën 360,292,190 lekë ose 100 % ndaj planit vjetor dhe në sasi 242.7 km. Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 130,638,214 lekë ose 36% e planit ku përfshihen projektet:
  - Eleminim i pikave te zeza (Black Spots), ne rrjetin rrugor kombetar 2024.
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të siguris rrugore në akset e Rajonit Qendër Perëndim, LOTI 2 (2025);
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të siguris rrugore në akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2025);
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Lindje, LOTI 4 (2025);
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, LOTI 1 (2026);
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Perëndim, LOTI 2 (2026);
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2026);
  - Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Lindje, LOTI 4 (2026);
  - Eleminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar 2026.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 28% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Projektet prioritare me financim të huaj janë:

- Përmirësimi dhe rehabilitimi i Urave;
- Ndërtim segmenti rrugor Qukës – Qafë Pllocë;
- Ndërtim ByPass i Tiranës;

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime", përbën 26% të totalit të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 të MIE për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 29% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Projektet prioritare me financim të brendshëm janë:

- Ndërtim rrjeti kryesor furnizimi me ujë i fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë dhe rrjeti shpërndarës fshati Kërçisht i Sipërm faza e II;
- Ndërtimi i ujësjellësit Cërruj, Bashkia Dibër;
- Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të KUZ në zonën e Gjirit të Lalëzit
- Rikonstruksion në rrjetin ekzistues të ujësjellësit në zonën e Gjirit të Lalëzit;
- Sistemi i ri KUZ+ITUP në zonën turistike të Spillesë, Bashkia Kavajë;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve Rr:"Glaukia" dhe "Dalip Peza", Bashkia Durrës;
- Ndërtim ujësjellësi i fshatrave Klos, Selvijas, Qyrkan, Lumas dhe Floq, (NJ.A. Klos) dhe rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Selitë;
- Rikonstruksion i plotë i ujësjellësave të fshatrave Trash, Karthnek, Njesia Administrative Sheze, Bashkia Peqin;
- Ndërtimi i Ujësjellësi i fshatrave Polis-Sheh, Polis - Qëndër, Polis -Gurshpat, Bashkia Librazhd;
- Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti III;
- Ndërtim KUZ në lagjen Afrim, Bashkia Fier;
- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm të Njësisë Administrative Kurjan;
- Ndertim i ujesjellesave te fshatrave Fushe Bardhe dhe ZhulaT, Bashkia Gjirokastër;
- Furnizimi me ujë i fshatrave Merqi dhe Raboshtë, Bashkia Lezhë;
-

- Furnizimi me ujë i fshatrave Goricaj, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate, Gradisht, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babubje e re në Njësinë Gradisht;
- Stacioni i ri te pompave në Gajde, dublim pusi, depo e re dhe plotësimi i linjave të dërgimit për njësitë Fiershegan, Allkaj, (Cukas, Toshkez), Krutje (Fier i Ri), Bubullime (Imsht);
- Ndërtim ujësjellësi rajonal Trebinje burimet e Kozicës,Bashkia Pogradec;
- Ndertimi i sistemit te kanalizimeve te Njesise administartive Udenishte, Bashkia Pogradec;
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve dhe rehabililitimi i stacioneve të pompimit të ujrave të ndotura Ksamil;
- Ndërtim i rrjetit (K.U.N) në lagjen "Baba Rexhepi", Rruga "Idriz Alidhima, Lidhja e kolektorit të bulevardit të ri në rrugën"Jonianët" dhe zëvendësimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit të ujrave të zeza", Sarandë;
- Rrjeti shpërndares plotesues i ujesjellësit të qytetit Delvinë;
- Ndërtim i ujësjellësit Çukë-Bërdënesh, Bashkia Sarandë;
- Ndërtim i ujësjellësit Bardhaj Bleran Bashkia Shkodër;
- Ndërtim i ujësjellësit Bajzë dhe fshatrat përreth loti 2;
- Furnizim me ujë i fshatit Tamarë, Bashkia Malësia e Madhe;
- Sistemi i furnizimit me ujë të Aeroportit të Vlorës;
- Ndërtim i Rrjetit të Kanalizimeve nga Lungomare deri në hyrje të Radhimës, Vlorë;
- Furnizimi me ujë te zonave bregdetare, zonat e investimit strategjik, Draleos, Drimadhës dhe Dhërmi të Bashkise Himarë, Faza III;
- Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat;
- Shtesa e Impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm, Boville 1800l/s faza e II me 1200 l/s;
- Instalimi i matësave të ujit për abonentet familjar në qytetin Bajram Curri;

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 20% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të huaj. Në projektet që po implementohen me burim financimi të huaj nga donatorët, përmendim:

- ✓ Infrastruktura Bashkiake, III, IV, V;
- ✓ Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve;
- ✓ Projekti i rikonstruksionit të rrjetit të brendshëm për ujësjellësin e Bashkisë Durrës;
- ✓ Projekti i kanalizimeve Tirana e Madhe;

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Transporti Hekurudhor", përbën 11% të totalit të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 3% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 35% të buxhetit të rishikuar për vitin 2026 për shpenzimet kapitale me financim të huaj.

Projektet prioritare janë:

- ✓ Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Termali i pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë- Rinas 2;
- ✓ Zbatimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë-Hani I Hotit";
- ✓ Zbatimi i projektit inxhinierik dhe arkitektonik i godinave të stacioneve hekurudhore Durrës-Tiranë TTP-Rinas Aeroport;
- ✓ Zbatimin e punimeve ndërtimore për elektrifikimin e linjës hekurudhore Durrës-Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit;
- ✓ Hartimi i projektit të detajuar Rrogozhinë–Pogradec;

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Transporti Detar", përbën 0,11% të totalit të buxhetit të MIE për shpenzimet kapitale.

- ✓ Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 0,12% të buxhetit të rishikuar për vitin 2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.
- ✓ Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 0,08% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të huaj.

Tavani buxhetor i programi buxhetor "Mbështetje për Energjinë", përbën 5% të totalit të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm përbën 1% të buxhetit të rishikuar për vitin 2026 për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm.

Tavani buxhetor i programit për shpenzimet kapitale me financim të huaj përbën 17% të buxhetit të rishikuar të vitit 2026 për shpenzimet kapitale me financim të huaj.

Projektet prioritare janë:

- ✓ Konvikte të rinovuara me eficiencë të energjisë Qyteti Studentit nr.1, programi i Rehabilitimit të Konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas Parimit të Efiçencës së Energjisë (Faza I, Faza II);
- ✓ Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës (DKTI);
- ✓ Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës ne Kaskadën e Drinit;
- ✓ Program i Investimeve për Shpërndarjen e energjisë;
- ✓ Instalimi i matesave inteligjent dhe balancimi në pikat e transformimit, si dhe sistemi CRM Billing (ERP), Faza I;
- ✓ Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas termetit të vitit 2019 (Hua CDP);
- ✓ Rehabilitimi i rrjetit elektrik Himarë - Dhërmi

6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Mbështetur në analizën e performancës së zbatimit të projekteve në vazhdim dhe ecurisë që do të kenë projektet e reja prioritare të vitit 2026, MIE do të kërkojë rritje të performancës buxhetore dhe financiare përtej planit të rishikuar të buxhetit për vitin 2026.

Për periudhën e 4 mujorit të dytë të vitit 2026, janë raportuar në nivel programesh buxhetore detyrime të krijuara rishtazi për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm si vijon :

- o Programi "Furnizime me Ujë dhe Kanalizime", në vlerën 148,500,000 lekë;
- o Programi "Transporti Rrugor", në vlerën 2,807,892,000 lekë;
- o Program "Mbështetje për Burimet Natyrore", në vlerën 106,000,000 lekë;

7. PËRFUNDIME

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është e angazhuar maksimalisht në realizimin me efektivitet të buxhetit të vitit 2026. Në përfundim, për 4-mujorin e dytë të vitit 2026, realizimi i shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë rezulton në masën 44% kundrejt planit vjetor të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente paraqitet në masën 49%, ndërsa realizimi i shpenzimeve kapitale në masën 44%, nga të cilat 47% për financimin e brendshëm dhe 32% për financimin e huaj. Krahas ecurisë pozitive në disa programe, mbetet e nevojshme përshpejtimi i zbatimit të projekteve në programet me realizim të ulët,

përfundimi i procedurave të prokurimit, ndjekja e kontratave dhe përcaktimi i masave konkrete për realizimin e fondeve deri në fund të vitit. Strukturat përgjegjëse dhe ekipet e menaxhimit të programeve duhet të vijojnë monitorimin periodik të realizimit financiar dhe fizik, të evidentojnë në kohë devijimet dhe të propozojnë masat e nevojshme korrigjuese.